



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

EKSTRAKT

**i procesverbalit nga takimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi me z. Skender Hyseni ,
Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, të mbajtur më 22 korrik 2015**

Takimi u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.05

Takimin e hapi dhe e kryesoi z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në takim përveç Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe stafit të Ministrisë ishin të pranishëm edhe anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi : z. Bekim Bislimi, Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë; z. Bekim Jashari, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z. Radisav Perović , përfaqësues i Komunitetit serb; z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit për Komunitete; z. Nexhmi Rudari, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Sami Ajeti, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit në Nivel komunal; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z. Bunjamin Hoti, përfaqësues i OJQ-ve; z.Fadil Halimi, përfaqësues i Mediave lokale; z.Avni Shabani, përfaqësues i Komunitetit të biznesit dhe z. Idriz Hoxha, përfaqësues i komunitetit të personave me nevojë të veçanta.

Ndërsa munguan: znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Faik Muçiqi, përfaqësues i Emergjencave Civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: z. Isak Demiri, major përfaqësues i FSK-së.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, të nderuar anëtarë të KKSB-së mirë se keni ardhur në këtë takim, që mund ta konsiderojmë urgjent. Në takim kemi të pranishëm z. Skender Hyseni Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilit i me stafin e tij i dëshirojmë mirëseardhje. Ne kemi vendosur shpejt që ta organizojmë këtë takim, për arsye se Ministri është sot për vizitë në Komunën e Podujevës dhe dëshira e tij ishte që përveç takimit me struktura tjera të Komunës të takohet edhe me anëtarët e KKSB-së, në mënyrë që të diskutojmë çështje që janë aktuale dhe me interes. Sa për njoftim Këshilli për Siguri në Bashkësi është themeluar në bazë të Udhëzimit Administrativ dhe rregullativës ligjore përkatëse. Anëtarët e këshillit janë të caktuar sipas detyrës zyrtare por janë të përfaqësuar edhe institucionet tjera siç parashihet me Udhëzim. Këshilli mban takime të rregullta sipas Udhëzimit Administrativ, në të cilat takime pikë standarde e rendit të ditës është situata e sigurisë në Komunë për të cilën vazhdimisht referojnë Komandanti i Stacionit të Policisë dhe përfaqësuesit e KFOR-it, por natyrisht pikat tjera të rendit të ditës janë për çështjet aktuale dhe që ne i parashohim në bazë të Planit të punës së Këshillit. Vlerësimet e përgjithshme janë që situata e sigurisë në Komunën e Podujevës është e qetë dhe stabile, veprat e të gjitha natyrave janë në rënie në bazë të statistikave që ne i marrim nga Stacioni policor, nga Komandanti. Duhet theksuar se në dy vitet e fundit nuk ka asnjë rast vrasjeje dhe konfliktet mes qytetarëve janë në minimum, por janë disa vepra që sigurisht na brengosin sikurse është prerja ilegale e pyjeve në territorin e Komunës por edhe në territoret e disa komunave tjera për çka ne e kemi diskutuar këtu dhe jemi munduar me të gjithë faktorët që të ndalojmë këtë dukuri. Problem tjetër që neve na shqetëson desha të ju informoj për Shërbimin e Zjarrfikësve, i cili duke pas parasysh numrin e banorëve dhe territorin e Komunës, është shumë i vogël, i mangët, ka një personel prej 16 punonjësve, me një mekanizëm dhe automjete të

stërvjetëruara. Me përjashtim të një automjeti të ri të cilin na ka dhuruar Ministria e Punëve të Brendshme, të gjitha automjetet janë donacione dhe dhurata nga shtetet mike, nga Gjermania, Austria etj. dhe shpesh janë në gjendje jo të rregullt kur paraqitet nevoja e intervenimeve sidomos gjatë verës kur numri i zjarreve është i madh. Për të mos zgjatur do të theksoja bashkëpunimin e shkëlqyeshëm të institucioneve të Komunës me Këshillin e Bashkësisë Islame- BIK-un. Kryetari i BIK-ut njëherit është edhe anëtar i këtij Këshilli. Është një konstatim i përbashkët se Komuna e Podujevës është ruajtur prej ndikimeve të ndryshe ekstreme radikale dhe besoj se do të vazhdojmë me ruajtjen e gjendjes ngase është një disponim i përgjithshëm edhe te Kryetari i BIK-ut dhe te Imamët e Xhamive dhe ne kemi kontakte të rregullta në forma të ndryshme. Duke pasur parasysh faktin se Komuna e Podujevës e ruan dhe praktikon besimin islam tradicional ashtu siç kërkohet, besoj se do ta ruajmë prej atyre ndikimeve që mund ta destabilizojnë edhe Bashkësinë Islame por edhe Komunën. Duhet theksuar edhe dukuritë tjera, ngase ne dëgjojmë informacione të ndryshme, nëpër komuna të ndryshme të Kosovës, si përdorimi i drogës, prostitucioni dhe dukuri tjera, ato në Komunën e Podujevës pothuajse janë ndoshta në minimum apo nuk ekzistojnë fare. Ju faleminderit, fillimisht fjalën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë, pastaj fjalën e ka z.Ministër.

z. Bekim Bislimi, përshëndes Ministrin e Punëve të Brendshme dhe gjithë të pranishmit. Sa i përket gjendjes së sigurisë në Komunën e Podujevës, ajo është e qetë. Kjo situatë mbretëron falë angazhimit të personelit të Stacionit Policor të Podujevës, Nënstacionit Policor në Orllan dhe gjithë aktorëve tjerë relevantë. Nga institucionet komunale kemi përkrahje të vazhdueshme dhe falënderim i veçantë u takon edhe qytetarëve të Komunës. Kjo gjendje vërtetohet në të dhënat statistikore që posedojmë. Kemi dukshëm rënie të veprave penale krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, po ashtu kemi rënie të aksidenteve në trafik. Përfundimisht periudha gjashtë mujore e vitit 2015 është 466 raste të iniciuara nga Stacioni Policor i Podujevës në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar që ishin 798, do të thotë kemi rënie prej 382 raste. Natyrisht se ne nuk jemi të kënaqur me këtë gjendje dhe jemi duke bërë përpjekje që kjo situatë të përmirësohet në të ardhmen. Gjatë realizimit të objektivave tona jemi duke u përballuar me disa vështirësi, në rend të parë me mungesën e burimeve njerëzore, duke marrë parasysh shtrirjen e gjerë gjeografike që ka rajoni i Komunës së Podujevës, numrin e popullsisë si dhe faktin që jemi në zonën kufitare. Gjithashtu edhe personeli mbi 20% prej tyre janë në moshë mbi 55 vjeç. Po ashtu përballemi edhe me mungesë të pajisjeve teknologjike, në këtë drejtim shfrytëzoj rastin dhe theksojë nevojën për furnizim me vetura zyrtare civile që ndikojnë dukshëm në kryerjen e punëve operacionale. Përkundër këtyre vështirësive, me një përkushtim dhe angazhim të vazhdueshëm të të gjithëve dhe përkrahjet nga strukturat më të larta të Policisë, rezultatet janë të theksuara.

z. Skender Hyseni, Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, faleminderit z. Kryetar, të nderuar anëtarë të KKSB-së, përfaqësuesë të mediave. Qëllimi i këtij takimi është që të ndikohet në një diskurs adekuat. Unë vlerësoj punën që ka bërë Kryetari i Komunës z. Agim Veliu për mbajtje të një gjendje sigurie do të thosha mbase më të mirën në Kosovë. Kjo është një arritur e madhe dhe natyrisht është rezultat i angazhimit të Kryetarit dhe organeve të sigurisë. Është me rëndësi jetike që KKSB të funksionoj dhe të mbahet kështu funksional në mënyrë që të adresohen të gjitha shqetësimet pa përjashtim që mund ti kenë qoftë individët qoftë komunitetet e ndryshme. Natyrisht këtu në mënyrë të veçantë e përshëndes kryetarin e Bashkësisë Islame dhe kam respekt të veçantë për kulturën adekuate të predikimit që e ka ruajtur Bashkësia Islame në Komunën e Podujevës dhe i inkurajoj që të vazhdojnë me këtë. Për më tepër sot do të kemi disa kërkesa shtesë, kërkesa që do tu drejtohen juve si qytetarë të ndershmë të këtij shteti në mënyrë që ti kryejmë ato obligime që i kemi ndaj vendit, ndaj familjes, ndaj qytetarit. Kryetari na foli për shqetësimet që qëndrojnë në rrafshin e zjarrfikjes dhe të sigurisë përgjithësisht dhe unë ju siguroj që MPB do t'i trajtoj me urgjencën dhe seriozitetin më të madh të gjitha ato kërkesa. Siç e diskutova me Kryetarin, qëllimi parësor i këtyre vizitave që do të bëj nga sot dhe ditëve të ardhshme nëpër komunat e Kosovës është që në rend të parë të bisedoj me KKSB-të për shqetësimet që kemi rreth radikalizmit të shoqërisë, në disa pjesë të Kosovës, rreth tendencave për ekstremizim të dhunshëm të shoqërisë. Kosova nuk mund të qëndroj indiferente karshi faktit që nga ky vend i vogël, në lufta të huaja të dhunshme, terroriste kanë marrë pjesë mbi 300 qytetarë të Republikës së Kosovës, flasim për ata që i dimë dhe i kemi identifikuar dhe ky është një fakt para të cilit ne nuk guxojmë të qëndrojmë indiferent, për më tepër na obligon që të mobilizohemi në çdo pikëpamje që shoqërinë e Kosovës ta ruajmë të paprekur nga ekstremizmet e ndryshme, nga radikalizimi, nga dhuna me bazë fetare, me ideologji fetare, sepse është predikament, themel i ngritjes

së shoqërisë së Kosovës. Ne e kemi definuar Kosovën edhe me kushtetutë si shtet sekular që e njeh plotësisht të drejtën e secilit qytetarë të predikoj fenë që e parapëlqen në pajtim dhe korniza, me ligjet në fuqi. Feja islame është fe e mirë, e pastër por fatkeqësisht të gjithë jemi dëshmitar që kjo fe është duke u keqpërdorë në mënyrën më të egër të mundshme, për qëllime të grupeve, e që ato nuk janë qëllime fetare, janë qëllime të skajshme të grupeve për përfitime me prirje të qarta radikale, terroriste, të dhunës, janë makabre skenat që i shohim në Siri, Irak, dhe në kryeqytete të ndryshme të Evropës, fatkeqësisht. Nuk jam këtu që të lë përshtypje se Kosova është kush e di çfarë rreziku, sot kam ardhur që të ju lus secilin prej jush që të mos kursehem në asnjë ditë të vetme, që të lëshoni mesazhin në nivel të shkollës, familjes, të denonconi çdo tendencë për radikalizim që vëreni. Është obligim qytetar edhe nacional dhe patriotik që kudo që hetoni tendencë të thirrjeve, diskurseve ekstremiste t'i denonconi ato sepse unë ju garantoj se me këtë i bëni mirë familjes, lagjes, komunitetit, fshatit, komunës dhe shtetit dhe të njëjtën kohë shpëtoni njerëz, të mashtruar, të manipuluar nga vuajtjet që përjetojnë shumica e qytetarëve që mbërrijnë në fushëbetejat makabre të Sirisë ose të Irakut. Është tragjike kur një familje të shohë vajzën 12, 14 vjeçare duke u bërë pre e shfrenimeve seksuale të idiotëve nëpër Siri e Irak. Prandaj është obligim i secilit nga ne që kudo që hetojmë këso prirjesh ti ndalim ata njerëz miqësisht dhe t'iu flasim, dmth. nuk mund të bëhet lufta efektive në nivel të MPB-së dhe Njësisë Antiterroriste të Policisë së Kosovës nëse nuk bëhet kjo në nivel të familjes, shkollës, klasës. Kur të krijohen situatat për nevojën e Njësisë Antiterroriste atëherë veç jemi para aktit të kryer. Natyrisht që duhet të merremi me ato situata edhe atëherë por atëherë veç kemi bërë veprim retroaktiv, ose kemi filluar të merremi me pasojat. Interes jetik i Republikës së Kosovës është që të mos merret me pasojat, por të bëjë veprime efektive parandaluese duke shtrirë dialogun dhe diskursin në të gjitha shtresat e shoqërisë, në të gjitha grupet e interesit dhe unë sërish këtu theks të veçantë i vendosi Bashkësisë Islame, qoftë në nivel komunal apo të Vendlit. Imamët janë kryesisht njerëz të urtë, të përgjegjshëm, të moralshëm dhe ata atë mesazh të predikimit adekuat të fesë duhet ta përçojnë çdo ditë, çdo kohë namazi, në çdo grumbullim fetar që bëhet. Kosova është pjesë e koalicionit global kundër ekstremizmit dhe kundër Isisit, një koalicion që udhëhiqet nga SHBA-të. Kosova ka marrë pjesë në Samitin e Shtëpisë së Bardhë që ka trajtuar luftën kundër ekstremizmit dhe ka marrë obligime të caktuara, bazuar në politikën shtetërore që ka, ta ruaj karakterin multietnik, multifetar dhe ka qëndrim fundamental nacional që ta ruaj karakterin sekular të shtetit dhe ta mbroj me fanatizëm të madh të drejtën e secilit qytetarë të Kosovës që ta predikoj fenë që e do, lirisht. Predikimi i fesë duhet të jetë në funksion të pasurimit shpirtëror e jo në funksion të ekstremizimit të shoqërive, të ndjelljes së dhunës sepse ajo s'ka të bëjë asgjë as me fenë islame, e unë ju siguroj edhe me asnjë fe tjetër. Krahasuar me vendet e rajonit Kosova ka bërë më së shumti institucionalisht për të adresuar problemin dhe ka ndërmarr veprime konkrete. Nuk kemi asnjë informacion që potencon se Kosova rrezikohet, mirëpo nuk duhet të presim si shoqëri që të merremi me pasoja por duhet të jemi shumë koshient për problemin, ngase problemi është real edhe vendet më të fuqishme ushtarakisht dhe teknologjikisht kanë probleme për tu mbrojtur, e lëre më ne. Institucionet e Kosovës, përkatësisht Ministria që unë e udhëheq, qëllim kryesor ka të siguroj ambient absolutisht të lirë që secili pavarësisht cilit besim fetar i takon apo etnisë të ushtroj besimin e vet lirshëm, natyrisht duke respektuar lirinë dhe jetën e tjetrit. Unë ju falënderoj për vëmendjen.

z. Shaban Ahmeti, falënderojmë Ministrin për vizitën e bërë Komunës së Podujevës. Nënvizoi, unë udhëheq Komitetin për Komunitete dhe sa i përket situatës së sigurisë apo raporteve ndëretnike dua të theksoj se ato janë shumë të mira, në nivelin e duhur.

z. Bekim Jashari, unë e përshëndes dhe i dëshiroj mirëseardhje Ministrin të MPB z. Skender Hyseni dhe është kënaqësi që sot është me ne në këtë takim, në një aktivitet siç e përmendi që do ta zhvillojë në të gjitha komunat. E përshëndes diskutimin e Ministrin që na jep vullnet dhe kurajë për punë, njëkohësisht falënderoj Kryetarin e Komunës dhe institucionet tjera komunale për bashkëpunimin shembullor që kemi. Dëgjova me vëmendje Ministrin dhe kuptova që si temë e ditës është një temë me interes për faktin që një pjesë bukur e madhe e qytetarëve tanë janë në dyshim se a ekziston rreziku në Kosovë apo jo. Është e vërtetë se Bashkësia Islame në Podujevë, ashtu sikurse Komuna mburret me sigurinë që ka në nivel, në raport me Komunat tjera. Si Bashkësi Islame e Komunës i kemi paraprirë shumë gjërave të cilave është dashur t'i paraprijë institucioni qendrorë dhe për këtë opinionin është në dijeni. Normalisht ka pas tendenca që të depërtojnë në rrugën tonë, mirëpo duke ju falënderuar Këshillit dhe imamëve përgjithësisht është bërë një punë e mrekullueshme në terren. Me kohë kemi dhënë udhëzimet imamëve tanë që të jenë të vëmendshëm në diskutimet e tyre

në opinion në lidhje me zhvillimet politike në botën arabe. Kemi theksuar se neve si shqiptarë nuk na interesojnë raportet politike në mes Arabisë Saudite dhe Iranit, por na intereson paqja në botë, por nuk jemi faktor që mund të ndikojmë në rregullimin e çështjes palestineze, pastaj çështja e Sirisë dhe Irakut që e përmendi Ministri i rendit, është e vërtetë se Siria ka probleme, është një konflikt i brendshëm dhe absolutisht aty nuk zhvillohet xihadi, aty zhvillohet një konflikt mes grupeve të cilat një pjesë të madhe të atyre grupeve i kanë krijuar imamë me ideologji radikale dhe ekstreme. Neve nuk dëshirojmë që ajo klimë të bartet në hapësirat shqiptare, veçanërisht në Republikën e Kosovës. Sa i përket Komunës në këtë rast nuk kemi të dhëna se kemi qytetarë tanë që luftojnë jashtë. Jemi të vendosur, unë personalisht si udhëheqës i Bashkësisë Islame në Komunë, nuk do të lejoj me asnjë çmim që një imam i ynë poqe se do të jemi në dijeni se po cenon me ligjërata dhe punën e tij rendin dhe Republikën, që bie ndesh me ligjet e Republikës, që bie ndesh dhe ofendon besimet e të tjerëve, sepse Islami është fe e pastër, por Islamin po e përdorin për qëllime dhe tendenca politike dhe ideologjike. Politikën tonë e udhëheqin qeveritarët. Qytetari ynë ka nevojë ti mësoj katër gjëra: besimin, drejtësinë, moralin dhe kulturën. Këto janë fundamentet bazë që i ka sjellë Islami. Por në këtë rast si Bashkësi Islame ju falënderojmë për mbështetjen e vazhdueshme. Ne do të vazhdojmë të ruajmë, siç theksoi edhe Kryetari Islami është një, por rrethanat na kanë detyruar të përdorim termin Islami tradicional, që e kemi shpjeguar dhe që na kanë mësuar hoxhallarët që kanë fol shqip dhe kanë menduar shqip, po flas pa keqkuptime për komunitetet tjera, po flas për besimin Islam. Besimin Islam na kanë mësuar shqiptarët. Ne kemi hoxhallarë të mëdhenj që i kanë shërbyer kombit. Hoxhallarët në Komunë të Podujevës qëndrojnë në vijë të shëndoshë. Në Bashkësinë Islame nuk kemi lejuar të inkadrohen kuadro për të cilët kemi dyshuar se kanë ideologji jo të mirë. Me asnjë çmim nuk i lejojmë. z. Ministër, përfundimisht institucionet tona i përgëzoj për një punë jashtëzakonisht të madhe që bëjnë dhe pse qytetarët kanë dëshirë për t'i ditur edhe imtësitë që zhvillohen. Është bërë një punë e mirë dhe në këtë kontekst llogarisni në institucionin e Bashkësisë Islame të Komunës së Podujevës.

z. Radisav Perović, theksoi, kam një kërkesë që është e njohur ngase e kam theksuar disa herë, për hapjen e një vendkalimi të ri kufitar Kosovë – Serbi, afër fshatit Metergoc. Meqë është prezent z. Ministër, kërkoj nga ai ta shqyrtoj këtë kërkesë. Ne jemi pak banorë dhe qarkullimi dhe kontaktet me familjet që i kemi në Serbi do të ishte shumë më i lehtë.

z. Skender Hyseni, Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, unë do ju siguroj se do të merrem me këtë çështje dhe do ta gjejmë zgjidhjen më të mirë të mundshme

z. Nexhmi Rudari, falënderojmë z. Ministër që ka ndarë kohë që bashkërisht sot është me ne t' i diskutojmë të gjitha ato shqetësime e që janë shqetësime reale jo vetëm për shtetin e Kosovës por edhe për qytetarët përgjithësisht. E përmendët rolin e shkollës dhe të institucioneve tjera arsimore në vetëdijësimin e nxënësve dhe të situatës për çështje të ndryshme që mund të shkaktojnë telashe në sigurinë e vendit. Ne si DKA dhe shkollat në përgjithësi kemi një bashkëpunim të mirë edhe me organizatat joqeveritare por edhe institucionet e sigurisë dhe shpesh herë bëjnë ligjërata me nxënësit siç është siguria në trafik, përdorimi i narkotikëve, trafikimi me qenie njerëzore etj, në mënyrë që të parandalojmë që në fillim çdo mundësi të rrezikohet nxënësi por edhe shoqëria në përgjithësi. Mund të zotohem para jush, në këtë bashkëpunim të mirë do ta avancojmë, kemi mundësi që për çështjen që jemi duke biseduar tash të fillojmë më seriozisht, t'i diskutojmë me nxënësit, me fëmijët tanë. Neve si institucione nuk na lejohet që mos të kemi qasje te secili nxënës te secili fëmijë te i cili mund të vërehen dyshimet më të vogla se është duke u indoktrinuar me ndonjë ideologji çfarëdo qoftë ajo e që nesër mund të jet më vështirë ta pengojmë apo ndalojmë, kështu që mund të them dhe mund të bëjmë ftesë për një ngritje të bashkëpunimit me Stacionin e Policisë edhe pse ne kemi një bashkëpunim të shkëlqyer, por edhe me institucionet tjera të sigurisë dhe bashkërisht të fillojmë me ligjërata konkrete me fillimin e vitit të ri shkollor jo vetëm për çështjen e cekur por për të gjitha çështjet që mund të jenë në interes të shtetit dhe shoqërisë.

z. Isak Demiri, përfaqësues i FSK-së, theksoi, ne jemi në mbështetje të KKSB-së. Nënvizoi, kemi një bashkëpunim dhe koordinim të mirë të punëve me Kryetarin e Komunës, gjithashtu me Komandantin e Stacionit të Policisë dhe besoj se edhe në të ardhmen do ta vazhdojmë këtë bashkëpunim.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, nëse më lejoni e përmbyll këtë takim, ju falënderoj për pjesëmarrje dhe kontribut edhe njëherë falënderojmë Ministrin dhe besoj në bazë të nevojave dhe kërkesave do të kemi prapë në takime.

Mbledhja përfundoi në orën 11.55

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani

Nr. 02-006-80154

Podujevë,

22 korrik 2015

Kryetari i Komunës

Agim Veliu